



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 66

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

Prishtinë, më 19 mars 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Liburn Aliu.

Munguan: Sasha Gjokiq.

I ftuar: Ministri i Shëndetësisë z.Ferid Agani

Të pranishëm: Aurora Bakalli , deputete, Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Enis Halimi, zyrtar i lartë i Fushës për Shëndetësi, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.03.2013
3. Takimi me Ministrin e Shëndetësisë z. Ferid Agani
4. Shqyrtimi i projektligjit për kontrollin e duhanit
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.03.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e datës 13.03.2013

3. Takimi me Ministrin e Shëndetësisë z. Ferid Agani

Fikrim Damka- Falënderoj ministrinë për pjesëmarrjen dhe kërkoj që para kalimit në diskutimin për inspektoratin, ministri të jap disa sqarime shtesë për ligjin e shëndetësisë, i cili është ndaluar në disa pika nga Gjykata Kushtetuese.

Time Kadrijaj- Propozoi që diskutim i parë të jetë çështja e Inspektoratit të Shëndetësisë.

Ferid Agani – Falënderoj deputetet për ftesën e cila i sipas tij i jep Komisionit mundësi që drejtpërdrejt të jetë i informuar me aktivitetet e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe që të diskutojë temat konkrete të cilat janë ngritur.

Ai tha se çështja e Inspektoratit është ngritur që nga ditët e para e fillimit të mandatit të krye inspektore, dhe atë në Kuvendin e Kosovës, nga ana e deputetes Kadrijaj, ku është pa si problematike çështja e funksionimit të njëkohshëm si kryeinspektore shëndetësore dhe si specializante në fushën e shëndetësisë publike. Ai tha se në përgjigjen e dhënë në Kuvend në këtë pyetje parlamentare kam thënë: Kryeinspektorja do ta kryej detyrën e saj në pajtim me kontratën e saj me Ministrinë e Shëndetësisë si Kryeinspektore shëndetësore dhe nuk do të ketë asnjë lëshim, dhe sa i përket shkollimit specialistikë të saj, kompetencën e plotë e kanë Komiteti përkatës specialistikë dhe Bordi për shkollim specialistik.

Sipas informatave që kam nga shërbimi civil i MSH, kryeinspektorja shëndetësore i përgjigjet ministrit në bazë të ligjit, për zbatimin e politikave, por për çështjet administrative dhe për çështjet e angazhimit të saj ditor profesional, ajo i përgjigjet sekretarit të përgjithshëm të MSH. Sipas informatave, ajo e ka respektuar në tërësi orarin e punës dhe detyrat e punës gjatë kohës së angazhimit të saj si kryeinspektore dhe, ka treguar rezultate jashtëzakonisht të mira të punës, në ngritjen e performancës së Inspektoratit Shëndetësorë dhe në krijimin e parakushteve për avancimin e këtij inspektorati, dhe kështu unë nuk kam pasur vërejtje në punën e saj profesionale. Unë kam kërkuar nga shërbimi civil që të ndërpritet kontrata e shkollimit specialistikë për shkak të realizimit të dy kontratave, duke menduar se mund të ketë kolizion. Pas kërkesës time, shërbimi civil i MSH është përgjigjur se, MSH nuk ka kompetencë që të ndërpres kontrata të shkollimit specialistikë pa marrjen e mendimit nga Bordi i shërbimit përkatës specialistikë. Është iniciuar procedura, është marrë mendimi i Komitetit specialistikë, dhe Bordi në mbledhjen e mbajtur me 23.01.2013 duke u bazuar në shkresën zyrtare 055654 të datës 03.10.2012 për interpretim i cili i referohej shkresës zyrtare 051338 të datës 16.03.2012. Dhe pasi i është drejtuar Komiteti specialist të shëndetësisë publike, mori përgjigje zyrtare, se Bordi nuk ka asnjë bazë ligjore që të kontestoj vazhdimin e shkollimit specialistikë për këta specializante.

Ai shtroi edhe një çështje, e cila ka të bëjë me vështirësitë menaxheriale në raportin ndërmjet kryeinspektore dhe inspektorëve, si pasojë e keqinterpretimit, mungesës së komunikimit të rregullt etj.

Liburn Aliu- Tha se kryeinspektoria i ka inspektuar profesorët- mentorët e vet, edhe këta që e kanë dhënë mendimin inspektohen nga kjo kryeinspektore, sepse ata të gjithë janë punëtor shëndetësor, mendoj se ky është konflikt interesi.

Ferid Agani - Tha se mentorët i ka nga lamia e shëndetësisë publike, ata zakonisht nuk kanë ambulancë private. Inspektorati shëndetësor e mbikëqyrë zbatimin e veprimtarisë shëndetësore, kurse mentorët e saj janë në shërbime të niveleve akademike.

Flora Brovina- Pyeti se përse mendoni që nuk shkelet e drejta e inspektorëve nëse kryeinspektori e tejkalon pozitën e vet? Nëse kryeinspektori punon edhe privatisht, kjo paraqet shkelje. Si mund të jenë inspektorët efikas nëse kryeshefi i tyre e shkel ligjin. Ne kemi informata se kryeinspektorja shpesh ndërhyjnë edhe te dhënia e dënimeve.

Aurora Bakalli- Tha se detyra e këtyre inspektorëve është që të inspektojnë njëjtë, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat.

Ferid Agani- Tha se sa i përket ankesave që i përmendi deputetja Brovina, kanë filluar procedurat e shqyrtimit brenda Ministrisë së Shëndetësisë, dhe do të merren vendime përkatëse në lidhje me to. Në atë vendim do të ketë të drejtë anekse edhe kryeinspektorja edhe inspektorët, dhe ankesat do të shkojnë në këshillin e pavarur shëndetësor. Ligji konsideroj që nuk është shkelur, ndërsa çështja e aftësive menaxheriale është çështje që duhet të shqyrtohet me kujdes. Deri më sot shërbimi civil i ministrisë nuk ka asnjë shkresë, se kryeinspektorja nuk i plotëson detyrat e saj, dhe nuk kemi asnjë shkresë nga bordi për mbikëqyrjen e shkollimit specialistik, për ndonjë parregullsi.

Ndërsa sa i përket deputetes Bakalli, ai tha se ju e dini që ata profesor, ushtrojnë veprimtari akademike, dhe asnjëri prej tyre nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes së inspektoratit shëndetësor në lëmin e shëndetësisë publike, sepse ata nuk janë në shërbim të drejtpërdrejt për qytetarët, ata janë menaxher të departamenteve. Instituti kombëtar i shëndetësisë publike është subjekt i kontrollit të tyre.

Time Kadrijaj- Tha se ne si anëtar të komisionit parlamentar për shëndetësi, kemi për obligim që të mbikëqyrim zbatimin e ligjit. Me dokumentet që i keni sjell sot ku raportohet për vijueshmërinë e rregullt të specializanteve, thuhet se orari i punës si specializant është obligativ, puna e specializantit në institut shëndetësor fillon në 07:00 h, atëherë si ka mundësi që të njëjtit ta respektojnë edhe orarin në ministrinë e shëndetësisë edhe në institucionin shëndetësor?

Ferid Agani - Tha se përgjegjësin ligjore për shkollim specialistik e ka Bordi qendror për shkollim specialistikë dhe Komitetit përkatës për shkollim specialistikë. Këta anëtar të këtij bordi specialistik, kanë vlerësuar se ajo është duke e vijuar me rregull programin e saj dhe kaq, ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë. Unë vetë kam kërkuar që të ndërpritet, për shkak se kam

menduar se nuk mund të ketë cilësi nëse në të njëjtën kohë kryen specializim edhe ndonjë punë tjetër. Por përgjigjja e bordit është tjetër.

Salihe Mustafa- Tha se shqetësuese për mua është raporti i kryeinspektore me inspektorët. Sepse nëse këto raporte nuk janë të mira atëherë, mund të ketë pasoja, unë vetëm ju lus që të punoni më shumë në rregullimin e raporteve brenda këtij institucioni.

Ferid Agani- Tha se kjo çështje ka qenë preokupuese për mua që nga fillimi. Jemi angazhuar një kohë të gjatë në baza ditore për të gjetur rrugëdalje nga kjo situatë. Dhe nëse me të vërtetë kemi të bëjmë me parregullsi menaxheriale atëherë ne do të reagojmë sepse askush nuk është mbi ligjin. Pse këto qeshje nuk ngritën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës po shtroni çështje te tilla në Kuvend. Ju është dashur t'i ndjekni të gjitha rrugët ligjore para së të ngritët ky debat i parakohshëm këtu, edhe pse jo i dëmshëm por i pavend. Unë këtë debat e shoh si ndihmës që ju ma bëni në këtë çështje.

Fikrim Damak- Tha se inspektorët nuk e kanë dërguar në komisionin tonë si ankesë, por si informatë. Ashtu që ne si komision kemi kërkuar nga ju vetëm një informatë lidhur me çështjen.

Nazane Breca- Tha se problemin e kryeinspektore e kamë parë që nga fillimi dhe, kamë reaguar edhe unë menjëherë mbas deputetes Kadrijaj, por tash kur ajo ka kaluar në specializante vullnetare unë nuk e shoh më si problem, për arsye se vullnetarëve u lejohet orar fleksibil për me realizuar specializimin, dhe tash nëse mentori dhe profesorët e saj raportojnë se ajo po i përmbush obligimet e saj atëherë ata e marrin atë përgjegjësi.

Sa i përket informatës, në shohim se ajo është përzgjedhur edhe si asistente në Institutin e Shëndetit Publikë, që edhe kjo për mua nuk paraqet ndonjë problem, sepse ajo vikendeve mundet me realizuar këtë orar të saj. Problematike për mua është fakti që ajo në të njëjtën kohë është angazhuar edhe në Rezonancë, dhe këtu mendoj se është konflikt interesi për shkak se është institucion privat, ndërsa ajo punon aty por në të njëjtën kohë duhet edhe me inspektuar këtë institucion.

Dilema ime është te efikasiteti i punës së saj!

Ferid Agani – Tha se ekziston deklarata që dëshmon se, kryeinspektorja nuk e ka ushtruar veprimtarin e saj në Rezonancë që nga zgjedhja e saj si kryeinspektore.

Bahri Thaqi- Tha se specializimi në Kosovë është bërë diçka e shenjët, dhe në parim jam për me ju ndihmuar njerëzve me u specializuar sepse shumica e tyre nuk gjejnë vende pune, dhe e vetmja perspektiv e tyre është specializimi.

Aurora Bakalli-Tha se diskutimi im ka të bëjë me specializimet vullnetare. Nëse dikush kryen një specializim vullnetar në fund do ta ketë titullin e njëjtë si kolegu i tij i cili çdo ditë vjen në pune me përkushtim të madh. Pyetja ime është: A mendoni se mund të nxjerrim specialistë kualitativë nëse, këta specializantë do të kenë përkushtim në ndonjë punë tjetër ashtu siç paska kryeinspektorja në MSH, dhe me një fleksibilitet ta kryej punën e specializantit në lëmin e shëndetit publikë?

Ferid Agani- Synimi im është që ta ndërkrejmë specializimin vullnetar dhe të gjitha specializimet të jen të rregullta dhe me pagesë.

Gezim Kelmendi-Tha se ministri me marrjen e mandatit, të gjithë specialistëve vullnetar, ju ka ndërprerë pagesën e cila ka qenë obligtive në shumë prej 500-1000 Euro. Ai tha se në rastin e kryeinspektore nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit sepse Bordi specialistikë ka vlerësuar se nuk ka bazë ligjore t'i kontestohet specializimi.

Liburn Aliu- Tha se duhet të diskutojmë që ta ndërtojmë një bazë ligjore për këto çështje. Nuk duhet të përdoret autoriteti i profesorëve në mënyrë që ta ndërtojmë një përjashtim si në rastin e kryeinspektore.

Ferid Agani-Tha se kur ngritet një çështje në nivel politikë, pa u diskutuar në nivelin që i takon sipas ligjit, për mua është një përpjekje për të politizuar një situatë, kjo çështje nuk është diskutuar fare në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, sikur sot ta kishim dokumentin në të cilën thuhet se MSH nuk po e respekton një vendim të Këshillit, atëherë do të ishte ndryshe. Këtu nuk bëhet fjalë për përjashtim sepse nuk është vetëm kryeinspektorja por janë katër specialist-punëtor të MSH.

Në momentin që do ta zgjedhim problemin e pagesave do ta ndryshojmë udhëzimin administrativë, dhe nuk do të ketë më kontrata në dy vende të punës.

Kjo lëndë gjithashtu ka shkuar në Agjencionin Antikorrupsion, dhe sapo të merret vendimi në këtë agjencion , do ta zbatojmë.

Flora Brovina- Tha se fakti që inspektorët e kanë drejtuar tek ne këtë rast, nuk do të thotë që ne po e politizojmë. Realizimi i zbatimit të ligjit për shëndetësi varet shumë nga efikasiteti i këtij inspektorati, përkatësisht puna e këtyre inspektorëve.

Time Kadrijaj- Tha se në mënyrë kolegjiale po kërkojmë të bëhet një zgjidhje e duhur për këtë fenomen.Gjithashtu pajtohem me deputeten Bakalli dhe deputetin Thaqi, se duhet të këtë barazi në lejimin e vijimit të specializimit për të gjithë. Në seancat plenare ne kemi sjelluar fakte që kryeinspektorja ka qenë në listat e punëtorëve të evidentuar me ardhjen në punë në ora 07:00 edhe në MSH edhe në Institut.

Dukuri tjetër shqetësuese është, ndërprerja e stazhit të specializimit grave gjatë pushimit të lehonisë.

Ferid Agani- Tha se është i interesuar t'a ngrisë cilësinë në shkollimin specialistikë. Specializimi mund të kryhet edhe pa qenë fizikisht prezent, ai nënkupton shumë forma të edukimit, në fokus grupe, me seminare e punime shkencore etj.

Liburn Aliu- Tha se ne nuk po e vejmë në dyshim punën e saj si specializante, por si kryeinspektore. Ajo ka qenë e rregullt ndoshta në specializim gjatë orarit të punës njëjtë sikurse që ka qenë dashtë të jetë e rregullt edhe në MSH.

Fikrim Damka – Tani të diskutojmë për Projektligjin e shëndetësisë dhe për gjendjen në shëndetësi.

Ferid Agani- Tha se, si ministër kam kërkuar me qenë pjesë e procesit gjyqësor. Kemi paraqitur materialin plotësues dhe kemi qenë prezent në seancën dëgjimore, ku kemi paraqitur argumentet tona bashkë me përfaqësuesin e Kuvendit të Kosovës. Në seancë është kontestuar në tërësi ligji nga ana e deputetit Muja.

Mendoj se kemi qenë mjaft të argumentuar dhe presim deri në daljen e qëndrimit të Gjykatës. Realisht, të vetmen dilemë e kam tek **Neni 41**, paragrafi për punësimin e njëkohshëm publik-privat, duke marrë parasysh që gjykata është bazuar shumë në legjislacionin e shteteve të rajonit.

Sa i përket gjendjes në shëndetësi, ai tha se ka qenë jashtëzakonisht i angazhuar në sektor që nga miratimi i ligjit më 13 dhjetor 2012. Jam i përkushtuar që njëherë e përgjithmonë t'i ndalojmë keqpërdorimet në sektorin farmaceutik. Nuk e kam nënshkruar një kontratë në vlerë prej 1 milion e 270 mijë euro, e cila ishte e përgatitur në mënyrë jo ligjore. Ai rast është duke u audituar nga Auditori i Përgjithshëm, dhe nëse konstatohen parregullsia që po i supozoi, do ta dërgoj rastin në organet hetimore.

Lista esenciale e barnave shpallet nesër ose pasnesër e re, e reviduar. Brenda dy javëve të ardhëshme do të ristrukturohet në tri grupe në bazë të metodologjisë së OBSH ; në barna vital, në barna esenciale dhe në barna më pak esenciale. Kjo do të bëhet në bazë të kriterëve ndërkombëtar, në bazë të çmimit, dhe në bazë të mendimit të profesionistëve të lëmive të caktuar që i përdorin ato barna.

Paralelisht jemi duke e monitoruar zbatimin e kontratave të para që i kemi nënshkruar me institucionet publike shëndetësore nga ana e Agjencionit për Përkujdesjen Shëndetësore. Këto javët e fundit kemi arritur ta aktivizojmë institutin e onkologjisë, kemi filluar me shërbimet kardiologjike edhe në zemër të hapur, si dhe para disa dite kemi hapur repartin e emergjencës pediatrike.

Aurora Bakalli- Pyeti ministrin se a ka filluar të shfrytëzohet buxheti që është i paraparë të shfrytëzohet për trajtimet jashtë vendit, dhe kah po shkon ky buxhet, në rastet emergjente apo si është duke u bërë seleksionimi i këtyre pacientëve?

Ferid Agani- Tha se buxheti ka filluar të shfrytëzohet, dhe nëse është fjala për ndonjë rast të shpejtë ne kemi arritur me lejuar mundësinë e trajtimit të rasteve emergjente në bazë të vlerësimit të komisionit mjekësor.

Liburn Aliu- Tha se me datën 14 në ora 15:00, janë tërhequr nga QKUK-ja me urdhër të barnatores qendrore, ampulat seksiakson, prodhim i Farmakosit, cila ka qenë arsye?

Ferid Agani - Për rastin konkret nuk jam i njoftuar, por ne kemi reaguar për disa barna që kanë hyrë në kufi pa leje të importit. Kemi tërheq shumë seri që kanë hyrë në treg pa leje të importit.

Fikrim Damka - Pyeti se cila është situata në Qendrën Emergjente të QKUK-së?

Ferid Agani – Tha se Qendra Emergjente ka shumë probleme por mendojmë se në prill do të hapet qendra e rinovuar. Me rëndësi është se edhe pas renovimit kjo qendër nuk do të plotësojë nevojat për një Qendër Emergjente të Kosovës, prandaj kemi një projekt për një qendër emergjente të re e cila do të kushtoj 42 milion dollar. Ka ngel edhe 15 milion dollar të sigurohen, për të filluar ndërtimi i Qendrës Emergjente të re.

Fikrim Damka – Tha se në Kosovë kohën e fundit ka shumë paraqitje të sëmundjes së leukemisë , a keni ndonjë projekt apo hulumtim në këtë drejtim

Ferid Agani - Tha se jemi duke punuar në krijimin e kancer regjistrin dhe kemi një bord kombëtar për zhvillimin e shërbimeve onkologjike . Kemi edhe disa projekte për zhvillimin e resurseve hematologjike.

Fikrim Damka - falënderoj ministrin **Agani** për përgjigje në ftesën e Komisionit.

4. Shqyrtimi i projektligjit për kontrollin e duhanit

Fikrim Damka - Tha se raportet për Projektligjin për kontrollin e duhanit kanë ardhur nga komisionet tjera , dhe ka vetëm një vërejtje nga Komisioni për Integritet , që ka kundërshtuar amendamentin 20 të propozuar nga Komisioni , që ka të bëjë me sponsorizimin për çështje humanitare .

Flora Brovina – Tha se në Kosovë ndihet nevoja për sponsorizim humanitar , por pasi kemi vërejtje nga Komisioni për Integritet , mund ta tërheqim amendamentin tonë sepse ndoshta edhe mund të keqëperdoret kjo dispozitë .

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që, sipas propozimit të Komisionit për integritet , të fshihet amendamenti 20 , i propozuar nga Komisioni .

Komisioni njëzëri miratohet raportin përfundimtar për Projektligjin për kontrollin e duhanit .

5. Të ndryshme

Nazane Breca - Propozoj që raporti me amendamente për Projektligjin për skema pensionale të financuar nga shteti, të plotësohet me një amendament të ri, që ka të bëjë me njohjen e stazhit pensional të të larguarve me dhunë nga puna.

Komisioni pas diskutimeve vendosi që raporti për Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, të diskutohet edhe një herë në grupin punues , dhe në mbledhjen e radhës të miratohet në Komision.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka